

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

PN.II. 8/2015

PKR 23/2015 Gjykata Themelore e Prishtinës
PN 340/15 Gjykata e Apelit

Data:

26 nëntor 2015

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki (kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues), Gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva- Ermenkova dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, dhe Zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Moyes si Procesmbajtëse, në lëndën penale me numër PKR 23/2015 pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës, kundër;

A [REDACTED] S [REDACTED], emri i babait [REDACTED], i lindur më [REDACTED]

A [REDACTED] P [REDACTED], emri i babait [REDACTED] i lindur më [REDACTED];

X [REDACTED] V [REDACTED], emri i babait [REDACTED] i lindur më [REDACTED];

K [REDACTED] K [REDACTED], emri i babait [REDACTED] i lindur më [REDACTED];

R [REDACTED] B [REDACTED] emri i babait [REDACTED], i lindur më [REDACTED];

Të dyshuar për veprat penale në vijim:

Pika 1 - A [REDACTED] S [REDACTED], A [REDACTED] P [REDACTED], X [REDACTED] V [REDACTED] K [REDACTED] K [REDACTED] dhe R [REDACTED] B [REDACTED]: **Krim të organizuar** në shkelje të nenit 274 §1 dhe §3 të Kodit Penal të mëparshëm (aktualisht sipas nenit 283 §1 dhe §2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së));

Pika 2 - A [REDACTED] S [REDACTED], A [REDACTED] P [REDACTED], X [REDACTED] V [REDACTED], K [REDACTED] K [REDACTED] dhe R [REDACTED] B [REDACTED]: **Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve** në shkelje të nenit 327 §1 dhe §2, nenit 23 të Kodit Penal të mëparshëm (aktualisht sipas nenit 372 §1 dhe §2, nenit 31 të KPRK-së);

Pika 3 A [REDACTED] S [REDACTED], A [REDACTED] P [REDACTED], X [REDACTED] V [REDACTED] K [REDACTED] K [REDACTED] dhe R [REDACTED] B [REDACTED]: **Mashtrim** në shkelje të nenit 261 §1 dhe §2, nenit 23 të Kodit Penal të mëparshëm (aktualisht sipas nenit 335 §1 dhe §2 dhe nenit 31 të KPRK-së);

Pika 4 - X [REDACTED] V [REDACTED] K [REDACTED] K [REDACTED] dhe R [REDACTED] B [REDACTED]: **Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit** në shkelje të nenit 339 §3, nenit 23 të Kodit Penal të mëparshëm (aktualisht sipas nenit 422 §1 dhe 2, nenit 31 të KPRK-së);

Duke vepruar lidhur me ankesën e paraqitur nga Prokurori i Shtetit më 11 shtator 2015 kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN Nr. 340/15 të datës 19 gusht 2015 (aktvendimi i kundërshtuar), me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorit Special kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 23/2015 të datës 28 maj 2015 mbi hedhjen poshtë të aktakuzës PPS 108/2010 si të paafatshme.

Pas shqyrtimit të përgjigjes në ankesë të paraqitur nga avokati mbrojtës [REDAKTUAR] në emër të A [REDAKTUAR] më 28 shtator 2015 dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga avokati mbrojtës [REDAKTUAR] në emër të A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] më 25 shtator 2015;

Pas këshillimit dhe votimit më 26 nëntor 2015;

Sipas nenit 41 l paragrafëve 6 dhe 9 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së)

lëshon këtë

AKTVENDIM

1. Ankesa e paraqitur nga Prokurori i Shtetit më 11 shtator 2015 kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN Nr. 340/15 të datës 19 gusht 2015, me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorit Special e datës 10 qershor 2015, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 23/2015 të datës 28 maj 2015 mbi hedhjen poshtë të aktakuzës PPS 108/2010 si të paafatshme, pranohet;
2. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit ndryshohet për të pranuar ankesën e Prokurorit Special të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, dhe për të refuzuar kundërshtimet ndaj aktakuzës në lidhje me paafatshmërinë e saj të cilat janë paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të pandehurve;
3. Lënda i kthehet Gjykatës Themelore të Prishtinës në mënyrë që kryetari i trupit gjykues të procedojë në përputhshmëri.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

1.1 Hetimi në këtë rast ka filluar më 21 tetor 2010, fillimisht kundër A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] X [REDAKTUAR] V [REDAKTUAR] dhe R [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] për kryerjen e pretenduar të veprave penale Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, Krim të organizuar, Mashtrim, Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit dhe Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi. Hetimi për këto vepra penale rrjedhimisht është vazhduar nga gjyqtari i procedurës paraprake sipas nenit 225 §2 të KPP-së së mëparshëm më 6 maj 2011 (duke e vazhduar hetimin deri më 21 tetor 2011) dhe më 20 tetor 2011 (duke e vazhduar

hetimin deri më 21 prill 2012). Hetimi është vazhduar për 6 muajt e fundit deri më 21 tetor 2012 me anë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të datës 24 prill 2012.

1.2 Më 9 qershor 2011, Prokurori Special ka lëshuar aktvendimin mbi zgjerimin e hetimit kundër dy të dyshuarve të tjerë A●●●●● dhe K●●●●● K●●●●● për akuzat Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, Krim të organizuar, Mashtrim, Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit dhe Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi. Kjo pjesë e hetimit kundër të dy të pandehurve është vazhduar dy herë nga gjyqtari i procedurës paraprake sipas nenit 225 §2 të KPP-së së mëparshëm, më 31 janar 2011 dhe më 03 korrik 2012. Vazhdimi i autorizuar i hetimit ka skaduar më 09 dhjetor 2012. Nuk është kërkuar vazhdim i mëtutjeshëm nga Prokurori Special.

1.3 Më 11 gusht 2011, Prokurori Special ka lëshuar aktvendimin mbi zgjerimin e hetimit kundër A●●●●● S●●●●● dhe A●●●●● P●●●●●, duke shtuar akuzën për Dhënie të ryshfetit sipas nenit 344 §1 të KPRK-së. Më 27 prill 2011, gjyqtari i procedurës paraprake ka autorizuar vazhdimin e hetimit për 6 muaj deri më 11 gusht 2012 sipas nenit 225 §2 të KPP-së së mëparshëm. Më 10 tetor 2012, Prokurori Special ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e hetimit, e cila është refuzuar me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 2 nëntor 2012, me arsyetimin se KPP-ja e mëparshme nuk e ka paraparë vazhdimin e dytë të hetimit për veprat penale që nuk janë të dënueshme me së paku 5 vite burgim.

1.4 Gjithashtu, më 11 gusht 2011, Prokurori Special ka zgjeruar hetimin kundër X●●●●● V●●●●●, K●●●●● K●●●●● dhe R●●●●● B●●●●● për veprën penale Marrje e ryshfetit sipas nenit 343 §1 të KPRK-së. Hetimi për këtë vepër penale është vazhduar më tutje me aktvendimin mbi vazhdim të datës 2 shkurt 2012, të ndryshuar më 20 prill 2012. Më pastaj, hetimi është vazhduar edhe një herë me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 30 nëntor 2012 edhe për gjashtë muaj të tjerë deri më 11 shkurt 2013.

1.5 Më 7 qershor 2013 dhe 19 korrik 2013, Prokurori Special ka lëshuar aktvendimet mbi pezullimin e hetimit. Më 19 janar 2015, Prokurori Special ka lëshuar aktvendimin mbi rifillimin e hetimit dhe rrjedhimisht më 19 janar 2015 ka ngritur aktakuzën PPS 108/2010.

1.6 Më 28 maj 2015, Gjykata Themelore ka lëshuar aktvendimin duke pranuar kundërshtimet e avokatit mbrojtës kundër aktakuzës dhe e ka hedhur poshtë si të paafatshme. Aktvendimi nuk i është refuzuar asnjërit kundërshtim të ngritur nga avokati mbrojtës përveç tij mbi paafatshmërinë e aktakuzës.

1.7. Më 10 qershor 2015, Prokurori Special ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit. Përgjigjet ndaj ankesës janë paraqitur më 18 qershor 2015 nga avokati mbrojtës ●●●●● në emër të pandehurit A●●●●● P●●●●●, dhe më 19 qershor 2015 nga avokati mbrojtës ●●●●● në emër të pandehurës X●●●●● V●●●●●, dhe më 19 qershor 2015 nga avokati mbrojtës ●●●●● në emër të pandehurit A●●●●● S●●●●●. Më 10 korrik 2015, Prokurori i Apelit ka paraqitur propozimin për miratimin e ankesës së Prokurorit Special. Gjykata e Apelit, me aktvendimin PN Nr. 340/15 të datës 19 gusht 2015, ka refuzuar ankesën e Prokurorit Specia, si të pabazuar.

2. Parashtrësit e palëve

2.1 Prokurorja e Shtetit pohon se aktvendimi është në shkelje të nenit 415 (1) nën-paragrafëve 1.1 to 1.4 të KPP-së. Ajo pohon se është shkelur e drejta e palës e garantuar me nenin 109 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 4 (2) dhe nenin 7 (1) pikat 1.7 dhe 1.8 të Ligjit mbi Prokurorinë e Shtetit, nenin 49 dhe nenin 415 të KPP-së. Nëse aktvendimi vërtetohet, do t'i shkaktoje Prokurorisë dëme të pariparueshme në ndjekjen penale të të pandehurve për veprat penale sepse në bazë të nenit 4 (1) dhe (2) të KPP-së, ndjekja penale e mëtutjeshme ndaj tyre nuk do të ishte e mundur për veprat e njëjta penale. Prandaj, aktvendimi e pengon Prokuroren e Shtetit në ushtrimin e autoritetit dhe përgjegjësisë për ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës. Prokurorja e Shtetit i propozon Gjykatës Supreme që ta ndryshojë aktvendimin e kundërshtuar dhe ta pranojë ankesën e Prokurorit Special të paraqitur kundër aktvendimit të kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës Themelore, dhe t'i refuzojë kundërshtimet e avokatëve mbrojtës kundër aktakuzës.

2.2 Lidhur me pranueshmërinë e ankesës, Prokurorja e Shtetit me respekt nuk pajtohet me arsyetimin dhe vendimin e aktvendimit të Gjykatës Supreme PN 2.1/2015 të datës 16 mars 2015, ku ankesa e paraqitur nga Prokurorja e Shtetit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit është e papranueshme. Gjykata Supreme ka theksuar, së pari se neni 408 (2) i KPP-së i cili ndalon ankesën kundër aktvendimit të kolegjit shqyrtues vlen për aktvendimet e Gjykatës së Apelit, dhe së dyti pasi që ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit nuk është listuar në nenin 374 të KPP-së, nuk është e pranueshme. Prokurorja e Shtetit pohon se 'kolegji shqyrtues' është forum për të gjykuar kundërshtimet kundër urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake, dhe prandaj në KPP është bërë dallimi nga kolegji i Gjykatës së Apelit. Për më tepër, lënda në fjalë nuk është më tutje në fazën hetimore, prandaj neni 408 (2) i KPP-së nuk zbatohet sipas analogjisë për të ndaluar ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në këtë lëndë. Lidhur me nenin 374 të KPP-së, Prokurorja e Shtetit pohon se Gjykata Supreme nuk ka vërejtur se kjo dispozitë nuk ofron një listë të gjerë të mjeteve juridike të cilat mund të ushtrohen gjatë procedurës penale, pasi që neni 374 (1) përcakton 'përveç kur parashihet ndryshe me këtë Kod ...'. Neni 411 (6) përcakton 'ndryshe. Ajo përfundon duke pohuar se ankesa aktuale sipas KPP-së është e lejueshme.

2.3 Lidhur me meritat e ankesës, Prokurorja e Shtetit pretendon si në vijim:

- aktvendimit të kundërshtuar i mungon arsyetimi mbi çështjen vendimtare sipas nenit 404 (1) të KPP-së.

- KPP-ja nuk përcakton kohën eksplicite për ngritjen e aktakuzës, por nuk është korrekte që interpretimi sistematik i KPP-së të jetë se aktakuza patjetër duhet të pasojë menjëherë pas përfundimit të hetimit, siç është theksuar nga Gjykata e Apelit. Nëse KPP-ja nuk përcakton një afat eksplicit për ngritjen e aktakuzës, atëherë nuk ka asnjë bazë ligjore për Gjykatën e Apelit që të përfundojë se aktakuza është e paafatshme. Aktakuza vetëm mund të hedhet poshtë nga kryetari i trupit gjykues në 'fazën e aktakuzës dhe deklarimit' në bazë të arsyeve

nga neni 253 (1) i KPP-së. Ky nen nuk e parasheh ngritjen e paafatshme të aktakuzës si arsye për hedhjen poshtë.

- Gjykata e Apelit citon aktvendimin e mëparshëm të Gjykatës së Apelit (PN 543/2015 të datës 15 gusht 2013) për të mbështetur arsyetimin, por nuk e citon në tërësi atë. Paragrafi 69 i atij aktvendimi thotë se 'Ngritja e aktakuzës nuk është verim hetimor, është veprim i veçantë prokurorial, i cili shënon fillimin e fazës së re të procedurës penale. Prandaj, neni 159 (1) i KPP-së nuk mund të shpjegohet ashtu që thuhet se aktakuza nuk lejohet nëse nuk ngritet brenda 2 vitesh nga nisja e hetimit.

- Aktvendimi i datës 15 gusht 2013 po ashtu pohon në paragrafin 71 se '...aktakuza mund të ngrihet me disa vonesa, po që se ajo vonesë është e arsyeshme. Cila vonesë është e lejueshme s ai përket drejtësisë së procedurës dhe respektimit të të drejtave të njeriut të të pandehurit duhet të vendoset nga ana e Gjykatës Themelore përkatëse në secilin rast veç e veç ...'. As Gjykata Themelore e as Gjykata e Apelit nuk kanë vlerësuar apo vërtetuar se vonesa në ngritjen e aktakuzës ishte e paarsyeshme dhe në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm. Çdo vonesë për sigurimin e provave të domosdoshme ishte bërë për shkak të vonesave në procesin e ndihmës juridike ndërkombëtare, marrjen e deklaratave të dëshmitarëve që detyruan heqjen imunitetit, dhe pritjen e ekspertizës financiare.

- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se "arsyeshmëria" e zgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në pikëpamje të rrethanave të lëndës ...' dhe jep kriteret'. Gjykata e Apelit nuk ka zbatuar këtë vlerësim.

- Neni 4 (1) KPP-së përcakton se vetëm vendimi i formës së prerë e ndalon ndjekjen penale të individit të njëjtë për veprën e njëjtë penale. Prandaj, asnjë dispozitë e ligjit nuk e pengon prokurorin aty ky provat mbështesin dyshimin e bazuar mirë.

2.4 Avokati mbrojtës [REDAKTUAR] në emër të A [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR] propozon që ankesa të hedhet poshtë si e papranueshme të vërtetohet aktvendimi i ankimuar. Ai parashtron se:

- e drejta për paraqitjen e ankesës kundër aktvendimit të shkallës së dytë të Gjykatës së Apelit nuk i plotëson kushtet ligjore, sipas nenit 408 (1) KPP-së.

- Si Gjykata Themelore ashtu edhe Gjykata e Apelit kanë dhënë arsyetime të forta, dhe me këtë kanë siguruar se nuk ka pasur asnjë shkelje të të drejtave të palëve.

- Ankesa shkel të drejtat ligjore dhe kushtetuese të të pandehurit (dhe të të pandehurve të tjerë) me anë të zvarritjes, duke bërë shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2.5 Avokati mbrojtës [REDAKTUAR] në emër të A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] kërkon që Gjykata Supreme të hedhë poshtë ankesën si të papranueshme. Ai parashtron se:

¹ *Frylander kundër. Francës* [GC], 27 qershor 2000, paragrafi 43.

- Ligji për prokurorinë e Shtetit (Ligji Nr. 05/L-034) neni 11.4 i jep kompetencë Prokurorit të Shtetit vetëm për paraqitjen e mjeteve juridike kur Gjykata Supreme vepron si gjykatë e shkallës së tretë. Gjykata Supreme vepron si gjykatë e shkallës së tretë vetëm në lëndët kur paraqitet mjete i jashtëzakonshëm juridik, siç është kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme nuk vepron si gjykatë e shkallës së tretë kur paraqitet mjete i zakonshëm juridik kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit .

- Nuk është bërë asnjë shkelje e nenit 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ligjvënësi ka paraparë një numër kufizimesh në ushtrimin e detyrës së prokurorisë.

- Kufizimet ligjore po ashtu janë paraparë me nenin 159 (1) KPP-së. Prokuroria nuk ka arritur t'i përfundojë veprimet e hetimit brenda afatit. Sistemi i drejtësisë nuk ka vendosur asnjë pengesë në hetime, kështu që prokurori nuk mund ta fajësojë sistemin e drejtësisë dhe të pretendojë në shkelje të të drejtave kushtetuese të Prokurorisë në ushtrimin e detyrës së ndjekjes penale.

- Gjykata e Apelit nuk kundërshtoi të drejtat e Prokurorisë siç përcaktohet me Kushtetutë, por vetëm ka theksuar parimin e ligjshmërisë lidhur me kohëzgjatjen e hetimit.

3. Gjetjet e kolegjit

3.1. Pranueshmëria e ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit

3.1.1 Ankesa e paraqitur nga Prokurori i Shtetit, dhe përgjigjet e paraqitur nga avokati mbrojtës [REDAKTUAR] në emër të A [REDAKTUAR] dhe nga avokati mbrojtës [REDAKTUAR] në emër të A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] janë të paraqitura me kohë.

3.1.2 Kolegji, me shumicë, gjen se ankesa e paraqitur nga Prokurori i Shtetit është e pranueshme.

3.1.3. Kolegji pajtohet me Prokurorin e Shtetit se neni 374 i KPP-së nuk siguron një listë të gjerë të rasteve kur janë të disponueshme mjetet juridike. Paragrafi 1 përfshin fjalët "Përveç nëse parashihet ndryshe sipas këtij kodi..."

3.1.4. Kolegji fillimisht konsideroi se, si parim kushtetues i paraparë me nenin 102 paragrafin 5, mund të paraqitet ankesë ndaj të gjitha aktvendimeve, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.

3.1.5. Qëndrimi i kolegjit është çdo shmangie nga ky parim duhet të përcaktohet shprehimisht në KPP me dispozita me fjali të qarta dhe të hollësishme. Në KPP nuk ekziston një ndalesë e tillë e përgjithshme për paraqitjen e ankesës në Gjykatë Supreme kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, përveç asaj që rrjedh nga neni 411 paragrafi 9.

3.1.6. Në përputhje me nenin 411 paragrafin 9 të KPP-së, ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit mund të hedhet poshtë drejtpërdrejt nga Gjykata Supreme pasi të sigurohet se nuk ngrit asnjë çështje të rëndësishme për të drejtat e mbrojtura me kushtetutë. Prandaj, ligjvënësi nuk lë asnjë dyshim se si parim i përgjithshëm, ndaj aktvendimeve të e Gjykatës së

Apelit mund të paraqitet ankesë vetëm nëse preket një çështje e rëndësishme për të drejtat e mbrojtura me kushtetutë. Përndryshe Gjykatës Supreme kurrë nuk do t'i jepej mundësia të vlerësojë nëse një çështje e tillë ishte paraqitur vërtetë për shqyrtim dhe se dispozita në fjalë do të ishte qartazi e tepërt.

3.1.7. Përveç kësaj, neni 408 paragrafi 4 shprehimisht përjashton ankesën kundër aktvendimit të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Prandaj, nëse ligjbërësi nuk lejon shqyrtimin e apelit nga ana e shkallës së tretë, atëherë edhe ky përjashtim do të ishte qartazi i tepërt.

3.1.8. Aktvendimi i kundërshtuar parandalon Prokurorin e Shtetit në ushtrimin e së drejtës për ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale, e drejtë e besuar atij me nenin 109 paragrafin I të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe prandaj duhet të konsiderohet e mbrojtur me kushtetutë. Prandaj kushti për pranueshmërinë e ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit është plotësuar.

4. Meritat e ankesës

4.1. Kolegji me shumicë votash e pranon ankesën. Është e qartë, dhe e pafat, që afati për ngritjen e aktakuzës nuk është përcaktuar në mënyrë specifike në KPP-në. Madje asnjë dispozitë e KPP-së nuk tregon hollësisht asnjë rrethanë kur aktakuza është e "paafatshme", ose për hedhjen poshtë të aktakuzës mbi këtë bazë.

4.1.1. Kolegji fillimisht e mori parasysh nenin 68 të KPP-së i cili cakton hollësisht katër fazat e ndryshme të procedurës penale: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik. Me këtë dallim të qartë të fazave të procedurës penale në KPP, kolegji gjen se qëllimi i ligjvënësit është i qartë se ngritja e aktakuzës hyn në fazën e dytë të procedurës penale (fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit) e jo në fazën e parë (fazën e hetimit). Kjo pikëpamje është e përforcuar me nenin 159 të KPP-së. Ky nen është shumë i qartë sa i përket afateve kohore të fazës së hetimit, dhe nuk përfshin asnjë dispozitë që përcakton se ngritja e aktakuzës duhet të bëhet brenda afatit të lejuar.

4.1.2. Kolegji pastaj e mori parasysh nenin 240 KPP-së, me të cilin caktohen hollësisht veprimet që Prokurori i ka në dispozicion pasi hetimi të ketë përfunduar. Paragrafi 1 përcakton procedurën para gjykatës në bazë të aktakuzës së ngritur nga Prokurori i Shtetit, dhe paragrafi 2, përndryshe, përcakton se Prokurori i Shtetit nxjerr aktvendim për pushimin e hetimit. Të dyja situatat, shprehimisht i referohen përfundimit të hetimit, dhe kolegji mendon se kuptimi i nenit është se ngritja e aktakuzës nuk është pjesë e fazës së hetimit, dhe prandaj nuk i nënshtrohet afateve kohore të përcaktuara me nenin 159 të KPP-së. Po ashtu është logjike që Prokurori i Shtetit nuk do të jetë në gjendje të marrë vendim se çfarë veprimesh të ndërmarrë – të ngreh aktakuzë apo të nxjerrë aktvendim. Po ashtu është e qartë se aktakuzat janë në mënyrë tipike dokumente të gjata dhe të hollësishme, që pashmangshëm marrin shumë kohë për t'u përgatitur me saktësi dhe plotësisht.

4.1.3. Kolegji me shumicë votash konstaton se nuk ka afat kohor për ngritje të aktakuzës. “Aktakuza e paafatshme” nuk është paraparë me anë të KPP-së. Prokurori i Shtetit është i kufizuar vetëm me anë të parashkrimit të veprës penale në fjalë. Megjithatë, Prokurori i Shtetit rekomandohet qartë të ngrit aktakuzë, kur një e tillë do të ngrihet, sa më parë pas përfundimit të hetimit, pasi rreziku për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme rritet me kalimin e kohës. Për më shumë, çdo gjykatë me rastin e vendosjes mbi meritat e akuzës penale me rastin e vendimit mbi dënimin gjithmonë do ta merr parasysh kohëzgjatjen e procedurës penale, në tërësinë e saj.

4.1.4. Gjykata Supreme e pranon ankesën e paraqitur nga Prokurori i Shtetit. Aktvendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Apelit ndryshohet për të pranuar ankesën e Prokurorit Special të datës 10 qershor 2015 të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 28 maj 2015. Kundërshtimet ndaj aktakuzës në lidhje me paafatshmërinë e saj të cilat janë paraqitur nga avokatët mbrojtës refuzohen. Aktakuza nuk është e paafatshme. Çdo kundërshtim tjetër kundër aktakuzës së ngritur nga avokati mbrojtës ende mbetet të shqyrtohet nga kryetari i trupit gjykues. Prandaj, lënda kthehet në Gjykatën Themelore të Prishtinës me qëllim që kryetari i trupit gjykues të procedojë në përputhje me rrethanat.

Kryetar i kolegjit

Procesmbajtës

Dariusz Sielicki

Kerry Moyes

Gjyqtar i EULEX-it

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarë të kolegjit

Republika e Kosovës
SAKTËSINË E KOPJES E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE

Gjyqtarja Elka Filcheva-Ermenkova


Avdi Dinaj

Gjyqtare e EULEX-it

Gjyqtar i Gjykatës Supreme